



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET  
E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT  
KOMISIONI I DEKLASIFIKIMIT DHE ZHVLERËSIMIT

Nr. 103 Prot.

Tiranë, më 11. 11. 2021

**BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH**

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika b), në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu II, neni 4, pika a), c), dhe në Udhëzimin nr. 99, datë 13.04.2018 “Për zbatimin e vendimit nr. 662, datë 15.11.2017 për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me Urdhër nr. 13, datë 03. 05. 2018 të Kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 20, datë 11. 11. 2021 si më poshtë:

**I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtëme:**

- 1. Drejtoria e I-rë, dosje nr. 99**, “Procesverbal mbi dorëzimin e dosjeve hetimore e gjyqësore të grupit armiqësor të sabotatorëve, A. K. me bashkëpunëtorët e tij”, 6 (gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret i Rëndësisë së Veçantë”. Dosja daton në vitet 1977.
- 2. Dosje formulare nr. 1962**, në ngarkim të A. K., me 109 (njëqind e nëtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja daton në vitet 1975-1977. Dosja i përket fondit ish Dega IV.
- 3. Fondi 4, Dosje nr. 191** “Dorëshkrime të A. K., me 227 (dyqind e njëzet e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja daton në vitet 1975-1977.
- 4. Fondi 4, Dosje nr. 192** “Dorëshkrime të A. K.”, me 295 (dyqind e nëntëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja daton në vitet 1975-1977.
- 5. Dosje me 4 fashikuj, në total me 55 (pesëdhjetë e pesë) fletë.** Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1984. Dosja i përket fondit ish Dega IV.

6. **Fondi 4, Drejtoria I-rë, dosje nr. 473** “Mbi disa mbishpenzime gjatë punës për montimin e fabrikës së pllakave në Elbasan”, me 3 (tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Dosja daton në vitet 1990.
7. **Dosje përpunimi nr. 1714**, në ngarkim të Gj. M., me 187 (njëqind e tetëdhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja daton në vitet 1974-1983. Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Lezhë.
8. **Dosje agjenturore “Sorra” nr. 1196**, në ngarkim të S. B., me 48 (dyzet e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Dosja daton në vitet 1987-1988. Dosja i përket fondit ish Dega IV.
9. **Dosje përpunimi nr. 3201**, në ngarkim të S. B., me 209 (dyqind e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja daton në vitet 1974-1990. Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Berat.
10. **Dosje formulare nr. 2 dhe nr. 2/1**, në ngarkim të S. S., me 2 volume, në total me 624 (gjashtëqind e njëzet e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja daton në vitet 1946-1990. Dosja i përket fondit ish Dega e Punëve të Brendshme Vlorë.
11. **Fashikull nr. 574**, në ngarkim të R. P., me 5 (pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja daton në vitet 1959-1990. Dosja i përket fondit ish të Arratisur.
12. **Dosje kërkimi dhe dosje fomulare nr. 574**, në ngarkim të Gj. N., me 36 (tridhjetë e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja daton në vitet 1951-1968. Dosja i përket fondit ish të Arratisur.
13. **Dosje agjenturore nr. 161 “Rrufeja”**, me 193 (njëqind e nëntëdhjetë e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja daton në vitet 1951-1973. Dosja i përket fondit ish të Operativ.

**KRYETARI I KDZH**

Gentiana Sula